

**TERMA REFERENCE**



**BASHKIA  
TIRANË**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA TIRANË**

**REALIZIMI I VIDEOVE TË SHKURTRA EDUKATIVE DHE VIDEO-PODCASTEVE  
PËR DIGJITALIZIMIN**

**Tiranë 2023**

<b>1. HYRJE</b>	<b>3</b>
<b>2. HISTORIKU/ SITUATA AKTUALE NË INSTITUCION</b>	<b>3</b>
<b>3. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA</b>	<b>4</b>
3.1. Objektivi i Përgjithshëm	4
<b>3.2. Qëllimi</b>	<b>4</b>
3.3 Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori	4
<b>4. SUPOZIMET DHE RISQET</b>	<b>5</b>
4.1 Supozimet e Projektit	5
4.2 Risqet	5
<b>5. QËLLIMI I PUNËS</b>	<b>5</b>
5.1 Të përgjithshme	5
5.2 Përshkrimi i detyrës	6
<b>6. HAPËSIRA GJEOGRAFIKE QË DO TË MBULOHET</b>	<b>8</b>
<b>7. SIGURIA E TË DHËNAVE TË VËNA NË DISPOZICION</b>	<b>8</b>
<b>8. LOGJISTIKA DHE KOHA</b>	<b>8</b>
8.1 Vendndodhja	8
<b>9. GRUPET E SYNUARA</b>	<b>8</b>
<b>10. PLANIFIKIMI I BUXHETIT</b>	<b>9</b>
<b>11. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT</b>	<b>9</b>
<b>12. KËRKESA FUNKSIONALE DHE TEKNIKE</b>	<b>10</b>

## **1. HYRJE**

### **1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues**

Bashkia Tiranë

## **2. HISTORIKU/ SITUATA AKTUALE NË INSTITUCION**

Tirana është një metropol që po përjeton një transformim modernizues dhe që është rikonceptualizuar nga aspekti urban si një qytet për të gjithë qytetarët. Bashkia Tiranë në kuadër të lehtësimit të procedurave në ndihmë të qytetarëve të saj, ka prioritet digjitalizimin. Digjitalizimi, inovacioni dhe sipërmarrja kanë marrë një fokus të veçantë e sidomos në formimin dhe përthithjen e aftësive të reja digjitale tek të rinjtë.

Me qëllim që të ndihmojë në ndërtimin dhe ecurinë e një ekosistemi të shëndetshëm, Bashkia Tiranë krijoi Digital Tirana, një vendtakim i shumë palëve, interesave, aktiviteteve dhe jetesës aktive të ekosistemit të sipërmarrjes dhe Inovacionit.

Platforma Digital Tirana është krijuar në 2021 duke sjellë së bashku një sërë elementësh të sektorëve privatë dhe publikë për të mbështetur startup, sipërmarrës, aktorë të ekosistemit si dhe për të dhënë një guidë të përgjithshme për nomadët digjitalë e që synon të ketë databazën më gjithëpërfshirëse të startup-eve, bizneseve dhe investitorëve në Tiranë.

Digital Tirana synon të krijojë një urë bashkëpunimi mes të rinjve të cilët nisin një sipërmarrje të re dhe aktorëve apo programeve financuese kombëtare dhe ndërkombëtare. Nëpërmjet kësaj platforme të gjithë aktorët e ekosistemit kanë mundësi jo vetëm të njihen me risitë më të fundit të inovacionit, sipërmarrjes dhe teknologjisë, por edhe të regjistrojnë startup-et e tyre si dhe të njihen me investitorë potencial.

Risitë teknologjike të kohëve të fundit kanë treguar se njerëzit dhe sidomos të rinjtë janë gjithnjë e më të hapur për të fituar informacion nëpërmjet mjeteve online. Një informacion i saktë, shterues dhe me burim të besueshëm për ekosistemin shqiptar të sipërmarrjes dhe teknologjisë, do të shtonte jo vetëm rëndësinë e ekosistemit, por edhe sasinë e informacionit të ofruar në shqip për një fushë jo shumë të zhvilluar në vendin tonë. Për këtë arsye, Bashkia Tiranë kërkon të rrisë ndërgjegjësimin dhe informimin publik për digjitalizimin e shërbimeve si dhe aktualitetin në ekosistemin startup, përmes realizimit të videove podcast të cilat do të zhvillohen në formate intervistash dhe videove edukative informuese të bazuara në një hulumtim mbi inovacionin dhe ekosistemin startup në Tiranë.

### **3. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA**

#### **3.1. Objektivi i Përgjithshëm**

Objektivi i përgjithshëm i shërbimit të kërkuar nëpërmjet kësaj kontrate është rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit publik përmes videove podcast të cilat do të zhvillohen në formate intervistash dhe videove edukative informuese, me fokus edukimin, teknologjinë dhe inovacionin.

Nëpërmjet këtij projekti kontraktori duhet të mundësojë:

- Krijimin e një logoje për projektin.
- Realizimin e regjisë, ideimin dhe konceptimin e përmbajtjes së video-intervistave duke propozuar një skaletë për materialin audio-viziv që do të prodhohet;
- Vënien në dispozicion të një ambienti/ salle /studio specifike për realizimin e regjistrimit e videove përgjatë shtrirjes kohore të projektit, kur është e nevojshme;
- Vënien në dispozicion të produkteve teknike specifike për realizimin e podcast-eve përgjatë shtrirjes kohore të projektit;
- Vënien në dispozicion të një stafi suporti mbështetës përgjatë shtrirjes kohore të projektit;
- Propozimin e skenarit dhe skaletës së videove edukative bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga BT si dhe bazuar në hulumtimin mbi inovacionin dhe ekosistemin startup në Tiranë.
- Realizimin, montimin dhe prodhimin e videove;

#### **3.2. Qëllimi**

Qëllimi i këtij projekti është rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit publik për aktualitetin e ekosistemit shqiptar të teknologjisë dhe sipërmarrjes si dhe informimi mbi çdo nisëm të Bashkisë Tiranë për të rinjtë në fushën e teknologjisë dhe sipërmarrjes.

#### **3.3 Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori**

Rezultatet e pritshme që duhet të arrihen nga Kontraktori në kuadër të kësaj kontrate/projekti do të jenë:

- 6 (gjashtë) video podcast të cilat do të zhvillohen në formate intervistash me përfaqësues të Bashkisë Tiranë duke prezantuar projektet e ndryshme të digjitalizimit dhe nismave për të rinjtë;
- 6 (gjashtë) video podcast të cilat do të zhvillohen në formate intervistash me përfaqësues të bizneseve dhe startup-eve të cilët do të japin perspektivën e digjitalizimit dhe inovacionit në punën e tyre;
- 6 (gjashtë) video edukative informuese të bazuara në një hulumtim mbi inovacionin dhe ekosistemin startup në Tiranë. Videot do të jenë të animuara dhe do të kenë një gjatësi prej maksimumi 3 (tre) minutash.

## **4. SUPOZIMET DHE RISQET**

### **4.1 Supozimet e Projektit**

- Projekti synon rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit publik përmes videove podcast të cilat do të zhvillohen në formate intervistash dhe videove edukative informuese, me në fokus edukimin, teknologjinë, inovacionin.
- Do të ngrihet një komision i posacëm në Institucion i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e projektit.
- Alokimi i burimeve njerëzore të nevojshme për implementimin e këtij projekti nga të gjitha palët e interesit.

### **4.2 Rrisqet**

Faktorët që parashikohen se mund të rrezikojnë mbarëvajtjen e kësaj kontrate, janë si më poshtë:

- Vështirësia e mundshme në bashkëpunimin me aktorët e ekosistemit të sipërmarrjes;
- Probleme teknike gjatë regjistrimit;
- Vonesa të mundshme në krijimin e kontentit;
- Moskoordinimi me përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë për realizimin e video - intervistave.

## **5. QËLLIMI I PUNËS**

Nëpërmjet kësaj kontrate, e cila synon promovimin e nismave digjitale të Bashkisë Tiranë, inkurajimin e të rinjve për të qenë pjesë e nismave digjitale të Bashkisë Tiranë, rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi digjitalizimin e shërbimeve, duhet të kryhen:

- Konceptimi, realizimi dhe prodhimi i videove podcast me individë të cilët kanë impakt në fushën e sipërmarrjes, digjitalizimit dhe administratës publike;
- Krijimi i videove të animuara për një fushatë informuese dhe sensibilizuese mbi ekosistemin e sipërmarrjes dhe teknologjisë në Tiranë;

### **5.1 Të përgjithshme**

Gjatë implementimit të kontratës Kontraktori duhet të mbajë në konsideratë:

- Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, (i ndryshuar)
- Ligjin Nr.35/2016, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”
- Ligjin Nr.25/2022, datë 10.03.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”;

## 5.2 Përshkrimi i detyrës

### Faza I - Faza Fillestare

Kjo fazë fillon në datën e nënshkrimit të kontratës. Gjatë kësaj faze, operatori ekonomik duhet:

- Të njihet me grupin e punës/komisionin në institucion, që do të jetë përgjegjës për monitorimin e implementimit të kontratës, duke vendosur linjat zyrtare të komunikimit;
- Të njihet me kuadrin ligjor në të cilin bazohet veprimtaria në Institucion dhe bazën ligjore në funksion të realizimit të projektit;
- Të caktojë një kalendar veprimi për ndjekjen e proceseve të punës së parashikuar sipas kontratës;
- Të prezantojë shembuj të punëve të realizuara më parë apo propozime të tjera dhe të vendoset versioni i videove dhe materialeve të tjera vizuale që do të përdoren në vijim të projektit, konkretisht:
  - Të propozojë minimalisht 3 versione të logos kryesore të projektit;
  - Të propozojë minimalisht 3 modele, skenare që do të ndiqen për krijimin e video-intervistave, për secilën prej tipeve;
  - Të propozojë minimalisht 3 modele që do të ndiqen për krijimin e videove të animuara;
- Të vendosë bashkë me grupin e punës/komisionin modelet e përmendura më lart;
- Planin e veprimit dhe metodologjinë për vijmësinë e projektit;
- Operatori Ekonomik duhet të përgatisë dhe dorëzojë në fund të kësaj faze, jo më vonë se një muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, projekt propozimin duke përfshirë:
  - Elementët e përmendur në këtë dokument dhe metodologjinë që do të përdoret për arritjen e objektivave të kërkuara;
  - Përmbledhje të rezultateve të takimeve me Autoritetin Kontraktor;
  - Formatin e dakordësuar për të trija tipologjitë e videove objekt kontrate dhe për logon e projektit;
  - Kalendarin e regjistrimeve për të gjithë intervistat që do të zhvillohen;

Vetëm pasi të miratohet sa më sipër kërkuar nga grupi përgjegjës/komisioni për monitorimin e implementimit të kontratës nga AK, do të vijohet me fazat e mëtejme të zbatimit të detyrave të kontratës.

### Faza II - Video-intervista

Kontraktuesi gjatë fazës së II-të do të mund të fokusohet në aktivitetet si më poshtë:

**Faza II-a** Kontraktuesi gjatë kësaj nënfaze do të mund të fokusohet në aktivitetet si më poshtë:

- Të realizojë regjistrimin e video-intervistave sipas kalendarit të vendosur në Fazën e I-rë;

- Ideimin, konceptimin, realizimin, montimin dhe prodhimin e video-intervistave me përfaqësues të Bashkisë Tiranë duke prezantuar projektet e ndryshme të digjitalizimit dhe nismave për të rinjtë;
- Vënien në dispozicion të një ambienti/salle /studio specifike për realizimin e regjistrimit e videove përgjatë shtrirjes kohore të kësaj faze nëse do të nevojitet një ambient ndryshe nga ato të Institucionit;
- Vënien në dispozicion të një stafi mbështetës përfshirë edhe regjisorin e prezantuesin/ intervistuesin.
- Vënien në dispozicion të produkteve teknike specifike për realizimin e podcast-eve përgjatë shtrirjes kohore të kësaj nënfaze;
- Të realizojë video përmbledhëse të cilat do të postohen më pas në kanalet e komunikimit të Bashkisë Tiranë;
- Në fund të kësaj faze Operatori Ekonomik do të dorëzojë fizikisht materialin e prodhuar dhe duhet të sigurojë AK se materiali i prodhuar përgjatë këtij projekti nuk do të përdoret në të ardhmen pa lejen e AK.

**Faza II-b** Kontraktuesi gjatë kësaj nënfaze do të mund të fokusohet në aktivitetet si më poshtë:

- Të realizojë regjistrimin e video-intervistave sipas kalendarit të vendosur në Fazën e I-rë;
- Ideimin, konceptimin, realizimin, montimin dhe prodhimin e video-intervistave me përfaqësues të bizneseve dhe startup-eve të cilët do të japin perspektivën e digjitalizimit dhe inovacionit në punën e tyre;
- Vënien në dispozicion të një ambienti/ salle/ studio specifike për realizimin e regjistrimit e videove përgjatë shtrirjes kohore të kësaj nënfaze;
- Vënien në dispozicion të produkteve teknike specifike për realizimin e podcast-eve përgjatë kësaj nënfaze;
- Vënien në dispozicion të një stafi mbështetës përfshirë dhe regjisorin, intervistuesin/ prezantuesin përgjatë shtrirjes kohore të kësaj nënfaze;
- Të realizojë video përmbledhëse të cilat do të postohen më pas në kanalet e komunikimit të Bashkisë Tiranë.
- Dorëzimi i të gjithë materialit të prodhuar me një harddisk të jashtëm të vënë në dispozicion nga OE.
- Në fund të kësaj nënfaze Operatori Ekonomik do të dorëzojë fizikisht të gjithë materialin e prodhuar dhe duhet të sigurojë AK se i materiali i prodhuar përgjatë këtij projekti nuk do të përdoret në të ardhmen pa lejen e AK.

### **Faza III - Video informuese të animuara**

Gjatë kësaj faze Operatori Ekonomik duhet të kryejë aktivitetet:

- Të realizojë prodhimin e videove të animuara video edukative informuese të bazuara në një hulumtim mbi inovacionin dhe ekosistemin startup në Tiranë, sipas kalendarit të vendosur në Fazën e I-rë;
- Vënien në dispozicion të produkteve teknike specifike për realizimin e videove përgjatë shtrirjes kohore të kësaj faze;

- Vënien në dispozicion të një stafi suporti mbështetës përgjatë shtrirjes kohore të kësaj faze;
- Dorëzimi i të gjithë materialit të prodhuar me një harddisk të jashtëm të vënë në dispozicion nga OE.
- Në këtë fazë Operatori Ekonomik do të dorëzojë fizikisht të gjithë materialin e prodhuar dhe duhet të sigurojë AK se i materiali i prodhuar përgjatë këtij projekti nuk do të përdoret në të ardhmen pa lejen e AK.

## **6. HAPËSIRA GJEOGRAFIKE QË DO TË MBULOHET**

Bashkia Tiranë.

## **7. SIGURIA E TË DHËNAVE TË VËNA NË DISPOZICION**

Kontraktuesi merr përsipër ruajtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave të vëna në dispozicion nga Bashkia Tiranë, me qëllim zhvillimin e projektit, arritjen e rezultateve dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga nënshkrimi i kontratës.

## **8. LOGJISTIKA DHE KOHA**

### **8.1 Vendndodhja**

Bashkia Tiranë

### **8.2 Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave**

Data për fillimin e këtij projekti është menjëherë pas nënshkrimit të kontratës dhe kohëzgjatja e implementimit të detyrave do të jetë 7 (shtatë) muaj nisur nga kjo datë.

## **9. GRUPET E SYNUARA**

- Administrata e Bashkisë Tiranë;
- Ekosistemi startup në Tiranë;
- Ekosistemi i teknologjisë në Tiranë;
- Të rinj dhe të reja entuziastë të inovacionit në kryeqytet;
- Audienca online përmes kanaleve të komunikimit.



## 10. PLANIFIKIMI I BUXHETIT

Nr.	Emërtimi /Përshkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi	Çmimi Total
1	Video Intervista (Realizim, montim, prodhim, dorëzim)				
1.1	FAZA II-a Video-intervista me përfaqësues të Bashkisë Tiranë	shërbim	1		
1.2	FAZA II-b Video-intervista me përfaqësues të bizneseve dhe startup-eve	shërbim	1		
2	FAZA III Video informuese të animuara (Realizim, montim, prodhim, dorëzim)	shërbim	1		
TOTALI PA TVSH					
TVSH (20 %)					
TOTALI ME TVSH					

## 11. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Faza	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7
1	Faza Fillestare							

2	Faza II Video- intervista							
2.a	FAZA II-a Video- intervista me përfaqësues të Bashkisë Tiranë							
2.b	FAZA II-b Video- intervista me përfaqësues të bizneseve dhe startup- eve							
3	FAZA III Video informuese të animuara							

## 12. KËRKESA FUNKSIONALE DHE TEKNIKE

### Specifikime në funksion të aktiviteve të projektit

Produktet e kësaj kontrate do të jenë material audio-viziv i prodhuar, konkretisht:

- 6 video edukative, të animuara të cilat do të kenë një gjatësi prej maksimumi 3 minutash;
- 12 video podcast. Intervistat: prezantim, pyetje- përgjigje, një informacion i shtrirë deri në max 30 min;
- 12 video përmbledhëse të podcasteve me kohëzgjatje max 1 min e 30 sec.
- 1 video përmbledhëse e të gjithë podcasteve me kohëzgjatje max 2 minuta.

Videot e mësipërme duhet të dorëzohen në formatet

- h264, UHD (Master)
- h264, HD

- mpg, HD
- h264, youtube

Informacioni i prodhuar: informacion i redaktuar, me përmbajtje autentike.

Operatori duhet të vërë në dispozicion produktet teknike specifike për realizimin e podcast-eve, live stream youtube 4k, 5x kamera Broadcast dhe çdo komponent tjetër të nevojshëm.

Operatori ekonomik duhet të vendosë në dispozicion ambient të përshtatshëm ose studio specifike për realizimin e regjistrimit e videove përgjatë shtrirjes kohore të projektit, kur është e nevojshme.

Përgjatë fazave të projektit, OE do të mundësojë staf mbështetës për të realizuar:

- Regjinë, ideimin dhe prodhimin e videove podcast dhe videove të animuara.
- Prezantimin dhe intervistat e video-podcast- intervista për Bashkinë Tiranë.
  - intervista për ekosistemin e teknologjisë dhe sipërmarrjes